



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE

PROJEKTVENDIM

Nr _____, datë _____ 2019

PËR

MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR SHPALLJEN E ZONAVE TË VEÇANTA TË RUAJTJES¹

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 29 të ligjit nr. 81, datë 04.05.2017 “Për zonat e mbrojtura”, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave.

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullave për shpalljen e Zonave të Veçanta të Ruajtjes (ZVR), e cila të kryhet mbi bazën e kriterëve të përcaktuara në pikën 1 të nenit 29 të ligjit “Për zonat e mbrojtura” dhe parashikimeve të këtij vendimi.

2. Në shpalljen e ZVR, merret në konsideratë që vlerësimi i rëndësisë së zonave për çdo habitat natyror, përfshirë tipat e habitateve natyrore kryesore dhe llojet kryesore, të bëhet sipas këtyre kriterëve:

- A. të vlerësimit të zonës për një tip të caktuar habitati natyror, me interes për komunitetin evropian;
- B. të vlerësimit të zonës për një lloj të caktuar, me interes për komunitetin evropian.

3. Kriteret e përcaktuara në pikën 2, janë të listuar në Aneksat e Direktivës së Habiteteve (92/43/EEC), të miratuar me Vendimin nr. 866, datë 10.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listave të tipave të habitateve natyrore, bimëve, kafshëve dhe shpendëve, me interes për Bashkimin Evropian”.

4. Shpallen, zona të veçanta të ruajtjes edhe territoret që ndodhen brenda dhe jashtë sistemit kombëtar të zonave të mbrojtura mjedisore, si më poshtë:

a) Zonat që gëzojnë statusin e zonës veçanërisht të mbrojtur si habitat i llojeve të shpendëve ujorë dhe përfshihen në listën e ligatinave me rëndësi ndërkombëtare (zonat Ramsar);

b) Zonat e rëndësishme për shpendët si habitat i shpendëve ujorë (IBA);

c) Zonat me interes për komunitetin evropian ku përfshihen zona të veçanta të ruajtjes

për:

i) habitatet dhe/ose llojet;

ii) dhe ii) shpendët;

ç) Zona të veçanta ruajtjeje si pjesë e rrjetit ekologjik kombëtar, si dhe ekosisteme,

¹ Ky projektvendim është përafuar me Vendimin Implementues të Komisionit i 11 Korrik 2011 “Për formatin e informacionit për zonën për zonat Natura 2000”; Celex Nr. 32011D0484, publikuar në Fletoren Zyrtare Nr. 198, datë 30.07.2011

habitate e peizazhe ose të lidhura me biokorridore me zonat e mbrojtura;

d) Zonat për llojet e faunës së egër, që gjenden në sipërfaqe të gjera, dhe përputhen me territoret brenda shpërndarjes natyrore të këtyre llojeve dhe që përfaqësojnë faktorë fizikë dhe biologjikë, thelbësorë për jetën dhe riprodhimin e tyre;

dh) Zonat për llojet ujore, që gjenden në sipërfaqe të gjera, mund të propozohen vetëm në rastet kur janë qartësisht të identifikueshme dhe përfaqësojnë faktorët fizikë dhe biologjikë, të domosdoshëm për jetën dhe riprodhimin e tyre;

e) Zona, rajoni biogeografik apo llojet, që ndikojnë dukshëm në mirëmbajtjen apo rivendosjen e tipit të habitatit natyror, me interes për komunitetin evropian ose me një status ruajtjeje të favorshëm, brenda rajonit apo rajoneve biogeografike;

ë) Zonat me interes të veçantë ruajtjeje (zonat Emerald) të identifikuara në kuadrin e zbatimit të konventës për ruajtjen e florës dhe faunës së egër dhe mjedisit natyror të Europës (Konventa e Bernës), në të cilën Republika e Shqipërisë është palë.

5. Ministria përgjegjëse për zonat e mbrojtura bashkërendon procesin e identifikimit të ZVR potenciale me Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura (AKZM), Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM), institucionet kërkimore e universitare dhe njësitë e qeverisjes vendore, për kryerjen e studimit me qëllim vlerësimin e zonave potenciale për t'u shpallur zona të veçanta të ruajtjes, duke përdorur bazën e të dhënave ekzistuese, përfshirë të dhënat dhe listën fillestare ekzistuese të ZVR. Mbi bazën e këtij studimi hartohet një listë paraprake e zonave që potencialisht plotësojnë kriteret për t'u shpallur si ZVR.

6. Lista e paraprake e ZVR-ve i nënshtrohet vlerësimit të mëtejshëm nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura sipas kërkesave të përcaktuara në shtojcën 1, bashkëlidhur këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij.

7. Ministria përgjegjëse për zonat e mbrojtura në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, mbi bazën e listës paraprake të zonave që plotësojnë kriteret për t'u shpallur si ZVR organizon diskutime dhe konsultim me grupet e interesit, përfaqësuesit e shoqërisë civile, institucionet akademike, për paraqitjen e propozimeve dhe marrjen e mendimeve për përmirësimin e listës së propozuar të zonave të veçanta të mbrojtje.

8. Ministria përgjegjëse për zonat e mbrojtura, në bashkëpunim me AKZM, brenda 6 muajve përgatit dokumentacionin për çdo zonë, pjesë të listës paraprake.

9. Pas përfundimit të procesit të konsultimit dhe përgatitjes së dokumentacionit të përcaktuar në pikën 8, ministri miraton, me urdhër, listën e zonave të veçanta të ruajtjes dhe së bashku me të dhënat përkatëse për çdo zonë, ia dërgon Komisionit Evropian.

10. Vendimi nr. 897, datë 21.12.2011 i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave për shpalljen e zonave të veçanta të ruajtjes", shfuqizohet.

11. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe Agjencia për Mbështetjen e Vetqeverisjes Vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

SHTOJCA I
I. IDENTIFIKIMI I ZONËS

1.1 TIPI

--

1.2 KODI I ZONËS

--	--	--	--	--	--	--	--

1.3. EMRI I ZONËS

--

1.4. DATA E PARË E PLOTËSIMIT

--	--	--	--	--	--

1.5 DATA E PËRDITËSIMIT

--	--	--	--	--	--

1.6 PERSONI PËRGJEGJËS

EMRI /ORGANIZATA:.....
ADRESA:.....
E-MAIL:.....

1.7 TË DHËNAT PËR ZONËN DHE DATA E PËRCAKTIMIT/KLASIFIKIMIT

DATA NË TË CILËN ZONA ËSHTË KLASIFIKUAR SI SPA²

V	V	V	V	M	M

REFERENCA LIGJORE KOMBËTARE E PËRCAKTIMIT TË SPA

DATA QË ZONA ËSHTË PROPOZUAR SI SCI³

DATA QË ZONA ËSHTË KONFIRMUAR SI SCI (*)

DATA QË ZONA ËSHTË SHPALLUR SI SAC⁴:

REFERENCA LIGJORE KOMBËTARE E SHPALLJES SË SAC

V	V	V	V	M	M

SQARIME

(**).....
.....
.....

² SPA "Zonë e veçantë e mbrojtur".

³ SCI "Zonë me rëndësi për komunitetin".

⁴ SAC "Zonë e veçantë për konservim".

* Opsionale, data e konfirmimit si SCI e dokumentuar nga DG Environment.

** Opsionale, shpjegimet mund të jepen p.sh. për datat e klasifikimit ose shpalljes si zona që janë të përbëra ose të ndara SPA dhe/ose SCI.

2. VENDNDODHJA E ZONËS

2.1 VENDNDODHJA E QENDRËS SË ZONËS (SHKALLË DECIMALE)

GJATËSI GJEOGRAFIKE

GJERËSI GJEOGRAFIKE

2.2 SIPËRFAQJA (HA)

2.3 SIPËRFAQJA DETARE (%)

2.4 GJATËSI E ZONËS (KM)

2.5 KODI DHE EMRI RAJONIT ADMINISTRATIV

NUTS KODI NIVELI 2

EMRI RAJONAL

2.6 RAJONI BIOGJEOGRAFIK

ALPIN (.....%)(*)

MESDHETAR (.....%)

ATLANTIK (.....%)

PANNONIAN (.....%)

DETI I ZI (.....%)

STEPIK (.....%)

BOREAL (.....%)

KONTINENTAL (.....%)

MAKRONESIAN (.....%)

INFORMACION SHITESË PËR RAJONET DETARE

MARINË ATLANTIKE (.....%)

MARINË DETI I ZI (.....%)

MARINË E DETIT BALTIK (.....%)

MARINË MESDHETARE (.....%)

MARINË MACRONESIAN (.....%)

3. INFORMACION EKOLOGJIK

3.1 Tipat e habitateve të pranishëm në zonë dhe vlerësimi në zonë për to:

Llojet e habitateve të aneksit I				Vlerësimi i zonës				
Kodi	PF	NP	Mbulesa (ha)	Shpella (numër)	AIBICID			
					Përfaqësueshmëria	Sip. relative	Ruajtja	Globalisht

PF: për llojet e habitateve që mund të jenë jo prioritare, si dhe një formë prioritare (6210, 7130, 9430) vendosni "x" në kolonën PF për të treguar formën prioritare.

NP: në rastin kur një lloj habitati nuk ekziston më vendosni kodin e zonës: x (opsionale)

Mbulesa: mund të vendosen vlera me shifra dhjetore

Shpella: për tipat e habitatëve 8310, 8330 (shpella) vendosni numrin e shpellave n.q.s. sipërfaqja e vlerësuar nuk është e vlefshme.

Cilësia e të dhënave: G= e mirë (p.sh. bazuar në studime); M= e moderuar (p.sh. bazuar në të dhëna të pjeshme me disa ekstrapolime); P=e dobët (p.sh. vlerësim i përafërt)

3.2 Llojet e referuara në nenin 4 të direktivës 2009/147/EC dhe llojet e listuara në aneksin II të Direktivës 92/43/EEC dhe vlerësimi i zonës për to

Llojet Grupi	Kodi	Emri shkencor	S	NP	Popullata në zonë		Njësia	Kat.	Cilësia e të dhënave	Vlerësimi i zonës				
					Tipi	Numri				AIBICID	AIBIC	Glob.		
													Min.	Maks.

Grupi: A = amfibë, B = shpendë, I = jovertebrorë, M = gjitarë, P = bimë, R = zvarranikë
 S: Në rast se të dhënat për llojet janë sensitive dhe prandaj duhet të bllokohen për çdo akses të publikut vendosni "po".
 NP: në rastet kur një lloj nuk është më i pranishëm në zonë vendosni x (opsional).
 Tipi: p = i përtheshëm, r = riprodhues, c = përqendrim, ë = dimëruës (për bimët dhe llojet jomigratore përdorni "i përtheshëm").
 Njësia: i = individë, p = çifte të njëjve të tjera në përputhje me listën e standardizuar të njëjve të popullatave në përputhje me nenet 12 dhe 17 të raportimit (*shih portalin e referencës*).
 Kategoritë e sasisë: C = i zakonshëm, R = i rrallë, V = shumë i rrallë, P = pranishëm – për t'u plotësuar në rast të të dhënave të pamjaftueshme ose përveç informacionit për numrin e popullatës.
 Cilësia e të dhënave: G = e mirë, M = e moderuar, P = e dobët, DD = të dhëna të pamjaftueshme

3.3 Lloje të tjera të rëndësishme të florës dhe të faunës (opsionale)

Llojet		Popullata në zonë					Motivacioni					
Grupi	Kodi	Emri shkencor	S	NP	Madhësia		Njësia	Kategoria CIRVIP	Aneksi i llojeve		Kategori të tjera	
					Minimumi	Maksimumi						

Grupi: A=amfibë, B=shpendë, F=peshq, Fu=kërpudha, I=jovertebrorë, L=likene, M=gjitarë, P=bimë, R=zvarranikë,

KODI: për shpendët, llojet e anekseve IV dhe V, kodit siç është dhënë në portalin referues duhet të përdoret së bashku me emrin shkencor.

S: Në rastin kur të dhënat për llojet janë sensitive dhe prandaj duhet të bllokohen për akses nga publiku, shkruani: yes (po)

NP: në rast se një lloj nuk është më i pranishëm në zonë vendosni x: opsional

Njësia: i=individë, p=çifte ose njësi të tjera në përputhje me listën e standardizuar të njësive të popullatave dhe kodet në përputhje me nenet 12 dhe 17 të raportimit (*shiko portalin e referencës*).

Kategoria: Kategoritë e sasisë: C=i zakonshëm, R=i rrallë, V=shumë i rrallë, P=pranishëm.

Kategoritë e motivacionit: Llojet e anekseve IV dhe V (direktiva e habitateve), A=të dhëna nga lista e kuqe kombëtare, B=endemike, C=Konventa ndërkombëtare, D: arsye të tjera.

4. PËRSHKRIMI I ZONËS

4.1 Karakteri i përgjithshëm i zonës:

Kodi	Klasa e habitatit	Mbulesa (%)
Mbulesa totale e habitatit		100 %

Karakteristika të tjera të zonës

--

4.2 Cilësia dhe rëndësia

--

4.3 Kërcënimet, presionet dhe aktivitetet me ndikime në zonë

Ndikimet më të rëndësishme dhe aktivitetet me efekt të madh në zonë

Ndikimet negative			
Renditja	Kërcënimet dhe presionet (kodi)	Popullata (opsionale)	Brenda/jashtë (i / o / b)
H			
H			
H			
H			
H			

Ndikimet pozitive			
Renditja	Aktivitetet, menaxhimi (kodi)	Popullata (opsionale)	Brenda/jashtë (i / o / b)
H			
H			
H			
H			
H			

Ndikime të tjera të rëndësishme me efekt mesatar/të ulët në zonë

Ndikime negative			
Renditja	Kërcënimet dhe presione	Popullata (opsionale)	Brenda/jashtë (i / o / b)

Renditja: H=i lartë, M=i mesëm, L=i ulët.

Ndotja: N=azoti, P= fosfori/fosfate, A= të dhëna për acide/acidifikimin, T= kimikate inorganike toksike, O= kimikate organike toksike, X= ndotje të ndryshme. i=brenda, o=jashtë, b= të dyja

5. GJENDJA E MBROJTJES SË ZONAVE (OPSIONALE)

5.1 Tipat e mbrojtjes në nivel kombëtar dhe rajonal

Kodi	Mbulesa (%)	Kodi	Mbulesa (%)	Kodi	Mbulesa (%)
<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>
<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>
<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>

5.2 Lidhja e zonës së përshkruar me zonat e tjera: të shpallura në nivel kombëtar dhe rajonal

Lloji i kodit	Enri i zonës	Tipi	Mbulesa (%)
<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>
<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>
<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>

të shpallura në nivel ndërkombëtar

Lloji	Enri i zonës	Lloji	Mbulesa (%)
Zona Ramsar	1	<input type="text"/>	<input type="text"/>
	2	<input type="text"/>	<input type="text"/>
	3	<input type="text"/>	<input type="text"/>
Rezerva biogenetike	1	<input type="text"/>	<input type="text"/>
	2	<input type="text"/>	<input type="text"/>
	3	<input type="text"/>	<input type="text"/>
Zonë eurodijplomë	-	<input type="text"/>	<input type="text"/>
Rezerve biosfere	-	<input type="text"/>	<input type="text"/>
Sitë i Konventës së Barcelonës	-	<input type="text"/>	<input type="text"/>
Sitë e Konventës së Bukureshtit	-	<input type="text"/>	<input type="text"/>
Zonë e trashëgimisë botërore	---	<input type="text"/>	<input type="text"/>
Zonë HELCOM	----	<input type="text"/>	<input type="text"/>
Zonë OSPAR	----	<input type="text"/>	<input type="text"/>
	----	<input type="text"/>	<input type="text"/>

5.3 Shpallja e zonës

6. MENAXHIMI I ZONËS

6.1 Organet përgjegjëse për menaxhimin e zonës:

Organizata: _____

Adresa: _____

E-mail: _____

6.2 Planet e menaxhimit:

Ekziston një plan menaxhimi për zonën:

Po

Emri: _____

Linku: _____

Emri: _____

Linku: _____

Jo, por është në përgatitje

Jo

6.3 Masat mbrojtëse (opsionale)

7. HARTA E ZONËS

INSPIRE ID

Harta e dorëzuar në PDF në formë elektronike (opsionale)

Po

Jo

Referenca(t) e hartës origjinale të përdorura për digitalizimin e kufijve elektronikë (opsionale)

